

V E N D I M
Nr.263, datë 7.6.1993

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.15, DATË
11.1.1993 "PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË NAFTËS DHE TË DISA NËNPRODUKTEVE
TË SAJ"**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e koksit të naftës dhe squfurit (bllok) të përcaktuara sipas vendimit nr.15, datë 11.1.1993, të konsiderohen si çmime maksimale.
2. Çmimet e artikujve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të vendosen për çdo rast nga ndërmarrja prodhuese në marrëveshje me blerësin. Këto çmime në asnjë rast nuk do të jenë mbi kufijtë maksimalë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi